FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.66 **8 qershor** **2007**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9733 datë 14.5.2007	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë" ……	1775
	Ndreqje gabimi …….	1893

LIGJ
Nr.9733, datë 14.5.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË TURQISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5333, datë 31.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE E TREGTISË SË LIRË
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË TURQISË

PREAMBULË

Me dëshirën për të zhvilluar dhe forcuar marrëdhëniet miqësore, veçanërisht në fushat e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtisë, me qëllimin që të kontribuojë në përparimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet të dy vendeve dhe për të zgjeruar fushën e shkëmbimeve tregtare reciproke,

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë (këtu e më tutje të quajtura "Palë" ose "Shqipëria" dhe "Turqia", sipas rastit);

duke konfirmuar synimin e tyre për të marrë pjesë aktive në procesin e integrimit ekonomik në Europë, duke shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në gjetjen e mënyrave dhe mjeteve për të forcuar këtë proces;

duke marrë parasysh "Marrëveshjen për Krijimin e Asociimit ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Komunitetit Ekonomik Europian" dhe "Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë";

duke pasur parasysh eksperiencën e fituar nga bashkëpunimi i zhvilluar ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje, si dhe ndërmjet tyre dhe partnerëve të tyre kryesorë tregtarë;

duke deklaruar gatishmërinë e tyre për të ndërmarrë aktivitete, me qëllim nxitjen e zhvillimit të harmonizuar të tregtisë së tyre, si dhe të zgjerimit dhe bërjes së larmishme të bashkëpunimit të tyre të ndërsjellë në fushat me interes të përbashkët, duke përfshirë fushat që nuk mbulohen nga kjo Marrëveshje, duke krijuar kështu një kuadër dhe mjedis mbështetës bazuar mbi barazinë, mosdiskriminimin dhe ekuilibrin e të drejtave dhe detyrimeve;

duke iu referuar interesit të përbashkët të Palëve dhe fuqizimin e vazhdueshëm të sistemit tregtar shumëpalësh dhe duke pasur parasysh që dispozitat dhe instrumentet e Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë 1994 (këtu quhet "GATT 1994") dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë (këtu quhet "OBT") përbëjnë një bazë për politikat e tyre tregtare me jashtë;

të vendosur që për këtë qëllim të hartojnë dispozita që synojnë në eliminimin progresiv të pengesave në tregtinë ndërmjet Palëve, në pajtim me dispozitat e këtyre instrumenteve, në veçanti atyre që kanë të bëjnë me krijimin e zonave të tregtisë së lirë;

kanë vendosur, në pajtim me këto objektiva, të përfundojnë Marrëveshjen (këtu e më poshtë të quajtur "kjo Marrëveshje").

Neni 1
Objektivat

1. Palët, duke pasur parasysh detyrimet e Turqisë që rrjedhin nga bashkimi doganor me BE-në dhe "Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së", do të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë në të gjithë tregtinë ndërmjet tyre, në një periudhë tranzitore që zgjat maksimalisht pesë vjet, që fillon nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në pajtim me nenin XXIV të GATT 1994 dhe të marrëveshjeve të tjera shumëpalëshe mbi tregtinë e mallrave, anekse të marrëveshjes që themeloi OBT-në.

2. Objektivat e kësaj Marrëveshjeje janë:

a) të zgjerojë dhe thellojë bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Palëve dhe të rrisë standardin e jetesës së popullatës së të dy vendeve;

b) të eliminojë gradualisht vështirësitë dhe kufizimet në tregtinë e mallrave;

c) të nxisë, nëpërmjet zgjerimit të tregtisë reciproke, zhvillimin e harmonizuar të marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Palëve;

d) të sigurojë kushte të drejta për konkurrencën në tregtinë ndërmjet Palëve;

e) të kontribuojë, me anë të heqjes të barrierave në tregti, në zhvillimin e harmonizuar dhe në zgjerimin e tregtisë botërore;

f) të krijojë kushte për inkurajimin e mëtejshme të investimeve, veçanërisht për zhvillimin e investimeve të përbashkëta në të dy vendet;

g) të nxisë tregtinë dhe bashkëpunimin ndërmjet Palëve në tregjet e vendeve të treta.

Neni 2
Tarifat doganore bazë

1. Në tregtinë ndërmjet Palëve që mbulohet nga kjo Marrëveshje, Palët zbatojnë tarifat e tyre doganore përkatëse mbi klasifikimin e mallrave për importet tek ato.

2. Për secilin produkt, tarifa doganore bazë që do të zbatohet dhe që do t'i nënshtrohet reduktimeve të mëvonshme, të parashikuara në këtë Marrëveshje, duhet të jetë tarifa e parimit të kombit më të favorizuar (MFN), që është në fuqi te Palët në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Nëse pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, zbatohen reduktime tarifore mbi bazën erga omnes, veçanërisht reduktime që rezultojnë nga negociatat tarifore në OBT, tarifat e reduktuara zëvendësojnë tarifat doganore bazë, të përmendura në paragrafin 2, që nga data e zbatimit të këtyre reduktimeve.

4. Tarifat doganore të reduktuara, të zbatuara nga Shqipëria, të llogaritura sipas parashikimit të kësaj Marrëveshjeje, rrumbullakosen në numra të plotë duke përdorur parime të njëjta aritmetike. Kështu, të gjitha shifrat që kanë më pak se 50 (e përfshirë) pas presjes dhjetore rrumbullakosen në numrin pasues më të vogël të plotë dhe të gjitha shifrat që kanë më shumë se 50, pas presjes dhjetore, rrumbullakosen në numrin pasues më të madh të plotë.

5. Palët i komunikojnë njëra-tjetrës tarifat doganore të tyre përkatëse bazë.

KAPITULLI I
PRODUKTET INDUSTRIALE

Neni 3
Fusha

Dispozitat e këtij kapitulli do të zbatohen mbi produktet origjinuese te Palët që përfshihen në kapitujt 25 deri 97 të përshkrimit të mallrave në sistemin e harmonizuar dhe sistemit të kodimit, me përjashtim të produkteve të listuara në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Detyrimet doganore mbi importet dhe tarifat që kanë efekt të njëjtë

1. Në tregtinë ndërmjet Palëve, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të zbatohet asnjë tarifë doganore e re mbi importet apo tarifë që ka efekt të njëjtë.

2. Detyrimet doganore mbi importet në Turqi, për mallrat origjinuese në Shqipëri, do të eliminohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Detyrimet doganore mbi importet në Shqipëri, për mallrat origjinuese në Turqi, të ndryshme nga ato të listuara në aneksin II, do të eliminohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

4. Detyrimet doganore mbi importet në Shqipëri të mallrave me origjinuese në Turqi, që janë të listuara në aneksin II, do të reduktohen progresivisht në pajtim me afatet e caktuara për to.

5. Për produktet e listuara në aneksin II, origjinuese në Turqi, Shqipëria jep një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që jepet për produktet e ngjashme origjinuese në Bashkimin Europian. Në rastin e një ndryshimi të favorshëm në trajtim të dhënë Bashkimit Europian për produktet e listuara në aneksin II, Shqipëria pa vonesë do të reflektojë këto ndryshime në produktet origjinuese në Turqi, të listuara në këtë protokoll dhe për këtë njofton menjëherë Turqinë.

6. Shqipëria dhe Turqia do të eliminojnë në tregtinë ndërmjet tyre çdo tarifë që ka efekt të njëjtë me detyrimet doganore mbi importet, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5
Detyrimet doganore të natyrës fiskale

Dispozitat në lidhje me eliminimin e detyrimeve doganore mbi importet do të zbatohen edhe për detyrimet doganore të natyrës fiskale.

Neni 6
Detyrimet doganore mbi eksportet dhe detyrimet që kanë efekt të njëjtë

1. Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në tregtinë ndërmjet Palëve, nuk do të zbatohet asnjë detyrim i ri doganor apo tarifa që kanë efekt të njëjtë mbi eksportet.

2. Të gjitha detyrimet doganore mbi eksportet ndërmjet Palëve dhe çdo tarifë që ka efekt të njëjtë do të eliminohet me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7
Kufizimet sasiore mbi eksportet dhe importet dhe masat që kanë efekt të njëjtë

1. Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje nuk do të vendosen kufizime të reja sasiore mbi eksportet dhe importet apo masa që kanë efekt të njëjtë.

2. Të gjitha kufizimet sasiore mbi eksportet dhe importet te Palët dhe masat që kanë të njëjtin efekt do të eliminohen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8
Barrierat teknike të tregtisë

1. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në lidhje me standardet ose rregullat teknike dhe masat përkatëse që lidhen me to, të rregullohen nga marrëveshja e OBT-së mbi barrierat teknike në tregti.

2. Palët do të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion në fushën e standardizimit, metrologjisë, vlerësimit të konformitetit dhe akreditimit, me synimin e eliminimit të barrierave teknike të tregtisë.

3. Secila Palë, me kërkesën e Palës tjetër, paraqet informacion mbi çështje të veçanta individuale të standardeve, rregullave teknike dhe masave të ngjashme.

KAPITULLI II
PRODUKTET BUJQËSORE DHE TË PESHKIMIT

Neni 9
Fusha

1. Dispozitat e këtij kapitulli do të zbatohen për produktet bujqësore bazë, produktet bujqësore të përpunuara dhe produktet e peshkimit, origjinuese në territorin e secilës Palë.

2. Termi "produkte bujqësore bazë, produkte bujqësore të përpunuara dhe produktet e peshkimit" (këtu e më tutje të quajtura "produkte bujqësore"), për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi nënkupton produktet që përfshihen brenda kapitujve 01 deri 24 të përshkrimit të mallrave në sistemin e harmonizuar dhe të sistemit të kodimit, përfshirë edhe produktet e listuara në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10
Shkëmbimi i koncesioneve

1. Palët në këtë Marrëveshje do të vendosin reciprokisht koncesionet e përcaktuara në protokollin I, në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.

2. Duke pasur parasysh rolin e bujqësisë në ekonomitë e tyre përkatëse, zhvillimin e tregtisë të produkteve bujqësore, ndjeshmërinë e lartë të produkteve bujqësore dhe rregullat e politikave përkatëse bujqësore, Palët do të shqyrtojnë në Komitetin e Përbashkët mundësitë e dhënies njëra-tjetrës së koncesioneve të tjera në tregtinë e produkteve bujqësore.

Neni 11
Masat sanitare dhe fitosanitare

1. Palët do të zbatojnë rregullat e tyre të brendshme në fushat e kontrollit veterinar, sanitar dhe fitosanitar, në pajtim me marrëveshjen e OBT-së mbi masat sanitare dhe fitosanitare.

2. Masat në lidhje me kontrollin veterinar dhe fitosanitar ndërmjet Palëve do të harmonizohen mbi bazën e legjislacionit të BE-së.

3. Palët angazhohen të mos vendosin masa diskriminuese ose masa të tjera, të cilat çojnë në kufizimin e parregullt të rrjedhës së informacionit në lidhje me nivelin e mbrojtjes sanitare dhe fitosanitare, kafshëve, bimëve dhe produkteve.

Neni 12
Masat mbrojtëse specifike

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dhe veçanërisht nenin 21, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e lartë të produkteve bujqësore, nëse importet e produkteve origjinuese te një Palë, që janë objekt i koncesioneve të dhëna në bazë të kësaj Marrëveshjeje në Palën tjetër, shkaktojnë shqetësime serioze në tregjet ose në mekanizmat e tyre të brendshme rregulluese, të dyja Palët do të fillojnë menjëherë konsultimet për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Deri në gjetjen e zgjidhjes, Pala e interesuar mund të marrë masat që ajo i mendon të nevojshme në pajtim me rregullat përkatëse të OBT-së.

KAPITULLI III
SHËRBIMET DHE INVESTIMET

Neni 13

1. Palët e kësaj Marrëveshjeje njohin rëndësinë në rritje të shërbimeve dhe investimeve. Në përpjekjet e tyre për të zhvilluar dhe zgjeruar gradualisht bashkëpunimin, veçanërisht në kontekstin e integrimit europian, ato do të bashkëpunojnë me qëllim nxitjen e mëtejshme të investimeve dhe arritjes së një liberalizimi progresiv dhe hapjen reciproke të tregjeve të tyre për investimet dhe tregtinë në shërbime, duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Përgjithshme të Tregtisë në Shërbimeve (GATS).

2. Palët do të diskutojnë në Komitetin e Përbashkët mbi këtë bashkëpunim, me qëllim zhvillimin dhe thellimin e marrëdhënieve të tyre në pajtim me këtë nen.

KAPITULLI IV
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 14
Taksimi i brendshëm

1. Palët do të heqin dorë nga çdo masë ose praktikë e një natyre të brendshme fiskale që përbën, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, diskriminim ndërmjet produkteve të një Pale dhe produkteve të ngjashme origjinuese në Palën tjetër.

2. Produktet e eksportuara në territorin e Palëve nuk duhet të përfitojnë nga rimbursimi i taksave të brendshme përtej shumës së taksës indirekte të zbatuar mbi to.

Neni 15
Bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë dhe tregtia ndërkufitare

1. Kjo Marrëveshje nuk pengon mbajtjen ose krijimin e bashkimeve doganore, zonave të tregtisë së lirë ose tregtinë ndërkufitare të Palëve me vende të treta, në masën që këto nuk ndikojnë negativisht në regjimin tregtar dhe veçanërisht në dispozitat në lidhje me rregullat e origjinës, të

parashikuara në këtë Marrëveshje.

2. Shkëmbimi i informacionit në lidhje me marrëveshjet që themelojnë këto bashkime doganore ose zona të tregtisë së lirë, do të bëhet me kërkesën e Palëve brenda Komitetit të Përbashkët.

Neni 16

Axhustime strukturore

1. Masa të jashtëzakonshme me kohëzgjatje të kufizuar, që anashkalojnë dispozitat e nenit 4, mund të merren nga Palët në formën e rritjes së detyrimeve doganore.

2. Këto masa mund të kenë të bëjnë vetëm me industritë e reja ose sektorë të veçantë që po kryejnë ristrukturime ose po përballen me vështirësi të mëdha, veçanërisht kur këto vështirësi shkaktojnë probleme të rëndësishme sociale.

3. Detyrimet doganore mbi importet, të zbatueshme te Palët, për produktet origjinuese në Palën tjetër, të vendosura me anë të këtyre masave, nuk mund të kalojnë 25% ad valorem dhe do të mbeten një element preference për produktet me origjinë në Palën tjetër. Vlera e përgjithshme e importeve të produkteve që u nënshtrohen këtyre masave nuk mund të kalojë 15% të importeve të përgjithshme të produkteve industriale nga Pala tjetër, sipas përcaktimit në nenin 3, gjatë vitit të fundit për të cilin jepen të dhënat statistikore.

4. Këto masa zbatohen për një periudhë që nuk i kalon pesë vjet, përveç kur autorizohet një kohëzgjatje më e gjatë nga Komiteti i Përbashkët. Ato pushojnë së zbatuari jo më vonë se skadimi i periudhës transitore.

5. Asnjë nga këto masa nuk mund të zbatohet në lidhje me një produkt nëse kanë kaluar më shumë se tre vjet që nga eliminimi i të gjitha detyrimeve dhe kufizimeve sasiore ose tarifat doganore apo masat që kanë një efekt të njëjtë, në lidhje me këtë produkt.

6. Palët njoftojnë Komitetin e Përbashkët për çdo masë të jashtëzakonshme që ato synojnë të marrin dhe, me kërkesë të Palës tjetër, në Komitetin e Përbashkët mbahen konsultime për ato masa dhe sektorë për të cilat ato zbatohen, para zbatimit të tyre. Gjatë marrjes së këtyre masave, Palët i japin Komitetit të Përbashkët një plan kohor për eliminimin e detyrimeve doganore të vendosura në bazë të këtij neni. Ky plan kohor parashikon ndërprerjen graduale të këtyre detyrimeve doganore, duke filluar jo më vonë se dy vjet pas prezantimit të tyre, me nivele të barabarta. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë për një plan të ndryshëm kohor.

Neni 17

Dumpingu dhe subvencionet

1. Asnjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk e ndalojnë Palën tjetër nga marrja e masave për mbrojtjen e tregtisë, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

2. Nëse njëra nga Palët konstaton se në tregtinë me Palën tjetër po ndodh dumping dhe/ose subvencion kundërbalancues, ajo Palë mund të marrë masat e përshtatshme kundër kësaj praktike, në pajtim me Marrëveshjen e OBT-së mbi zbatimin e nenit VI-të të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë 1994 dhe Marrëveshjen e OBT-së mbi Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese dhe legjislacionin e vet përkatës të brendshëm.

Neni 18

Masat mbrojtëse të përgjithshme

Nëse një produkt importohet në një nga Palët në sasi të tilla të rritura, secila Palë i mban të drejtat dhe detyrimet e saj në bazë të nenit XIX të GATT-it 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së mbi Masat Mbrojtëse. Kjo Marrëveshje nuk u jep Palëve të drejta ose detyrime shtesë në lidhje me masat mbrojtëse.

Neni 19

Rieksportimi dhe mungesat serioze

1. Nëse respektimi i dispozitave të neneve 6 dhe 7 çon në:

a) rieksport drejt një vendi të tretë, kundrejt të cilit Pala eksportuese në këtë Marrëveshje ruan për produktin përkatës kufizimet sasiore të eksportit, detyrimet për eksportin apo masat ose tarifat doganore që kanë efekt të njëjtë; ose

b) një mungesë ose kërcënim për mungesë serioze të një produkti thelbësor për palën eksportuese, dhe nëse situatat e përmendura më sipër shkaktojnë ose mund të shkaktojnë vështirësi të mëdha për Palën eksportuese, kjo Palë mund të marrë masa të përshtatshme në bazë të kushteve dhe në pajtim me procedurat e parashikuara në nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Masat e marra si rezultat i situatës së përmendur në paragrafin 1 do të zbatohen në një mënyrë jodiskriminuese dhe do të eliminohen nëse kushtet nuk e justifikojnë mbajtjen e tyre.

Neni 20

Monopolet shtetërore

1. Palët do të rregullojnë në mënyrë progresive çdo monopol shtetëror të një karakteri tregtar, për të siguruar që në fund të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të mos ketë diskriminim në lidhje me kushtet në të cilat prokurohen dhe tregtohen mallrat ndërmjet shtetasve të Palëve.

2. Komiteti i Përbashkët duhet të informohet në lidhje me masat e marra për të zbatuar këtë objektiv.

Neni 21

Procedura e njoftimeve dhe konsultimeve për zbatimin e masave

1. Përpara fillimit të procedurës për zbatimin e një mase të përmendur në nenet 12, 19, 24 dhe 32, Palët e kësaj Marrëveshjeje do të përpiqen të zgjidhin çdo ndryshim ndërmjet tyre me anë të konsultimeve të drejtpërdrejta dhe informojnë për këtë Palën tjetër.

2. Një Palë që mendon të marrë masa njofton për këtë menjëherë Komitetin e Përbashkët. Pala e interesuar i jep Komitetit të Përbashkët informacionin përkatës dhe i jep atij asistencën e duhur për të shqyrtuar çështjen. Konsultimet ndërmjet Palëve kryhen pa vonesë në Komitetin e Përbashkët me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme reciprokisht.

3. Nëse brenda një muaji që kur çështja i është dërguar Komitetit të Përbashkët, Pala përkatëse nuk i jep fund praktikës së kundërshtuar ose vështirësive të njoftuara dhe në mungesë të një vendimi nga Komiteti i Përbashkët për çështjen, Pala e interesuar mund të marrë masat që ajo i konsideron të nevojshme për të ndrequr situatën.

4. Masat e marra i njoftohen menjëherë Komitetit të Përbashkët. Ato kufizohen, në lidhje me masën dhe kohëzgjatjen, në atë që është tepër e nevojshme, me qëllim që të rregullohet situata, që ka shkaktuar zbatimin e tyre dhe nuk e tejkalojnë dëmin e shkaktuar nga praktika ose vështirësia në fjalë. Prioritet u jepet atyre masave që cenojnë më pak zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. Masat e marra u nënshtrohen konsultimeve të rregullta brenda Komitetit të Përbashkët, me qëllim zbutjen ose heqjen e tyre nëse kushtet nuk e justifikojnë vazhdimin e mbajtjes së tyre.

6. Nëse rrethanat e veçanta që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë shqyrtimin paraprak të pamundur, Pala e interesuar, në rastet e neneve 12, 19, 24 dhe 32, zbaton menjëherë masat parandaluese që janë tepër të nevojshme për të korrigjuar situatën. Masat i njoftohen menjëherë Komitetit të Përbashkët dhe zhvillohen konsultime ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje brenda Komitetit të Përbashkët.

Neni 22

Rregullat e origjinës dhe bashkëpunimi ndërmjet administratave doganore

1. Palët bien dakord që në tregtinë ndërmjet tyre të zbatojnë rregullat preferenciale europiane të origjinës, duke përfshirë të gjitha amendamentet ekzistuese dhe të mëtejshme. Në rast se këto rregulla të origjinës ndryshohen, Komiteti i Përbashkët fillon procedurën e ndryshimit të rregullave të origjinës.

2. Protokolli II i kësaj Marrëveshjeje përcakton rregullat e origjinës dhe metodat përkatëse të bashkëpunimit administrativ.

Neni 23
Pagesat

Palët marrin përsipër të autorizojnë, në një monedhë lehtësisht të konvertueshme, në pajtim me dispozitat e nenit VIII të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar, çdo pagesë dhe transfertë në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë.

Neni 24
Rregullat e konkurrencës në lidhje me sipërmarrjet, ndihma shtetërore

1. Çfarë vijon janë në kundërshtim me zbatimin e rregullt të kësaj Marrëveshjeje, në masën që ato mund të prekin tregtinë ndërmjet Palëve:

a) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet nga shoqatat e sipërmarrjeve dhe praktikat e planifikuara ndërmjet sipërmarrjeve që kanë si objekt të tyre ose ndikojnë në parandalimin, kufizimin ose deformimin e konkurrencës;

b) abuzimi nga një ose më shumë sipërmarrje me pozicionin dominues në territoret e Palëve si një e tërë ose në një pjesë thelbësore të tyre;

c) çdo ndihmë shtetërore që deformon ose kërcënon të deformojë konkurrencën, duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhimin e mallrave të caktuara.

2. Secila Palë do të sigurojë transparencë në sferën e ndihmës shtetërore. Me kërkesë të njërës Palë, Pala tjetër jep informacion në lidhje me raste individuale të veçanta të ndihmës shtetërore.

3. Nëse një Palë konsideron se një praktikë e caktuar nuk është në pajtim me termat e paragrafit të parë të këtij neni, dhe:

a) nuk trajtohet si duhet duke zbatuar rregullat e përmendura në paragrafin 4 të këtij neni, ose

b) në mungesë të këtyre rregullave, dhe nëse një praktikë e tillë shkakton ose kërcënon të shkaktojë dëme serioze në interesin e Palës tjetër ose dëm material në industrinë vendase, duke përfshirë industrinë e saj të shërbimeve, ajo mund të marrë masat e përshtatshme pas konsultimeve brenda Komitetit të Përbashkët ose pas tridhjetë ditë pune pas referimit për këto konsultime.

4. Në rastin e praktikave që nuk janë në pajtim me paragrafin 1 c) të këtij neni, këto masa të përshtatshme, nëse për këto zbatohet OBT/GATT 1994, mund të merren vetëm në pajtim me procedurat dhe kushtet e përcaktuara nga OBT/GATT 1994 dhe çdo instrument tjetër përkatës i negociuar nën kujdestarinë e tij, që janë të zbatueshëm ndërmjet Palëve.

5. Pavarësisht nga dispozitat me efekt të kundërt të miratuara në pajtim me këtë nen, Palët shkëmbejnë informacion duke marrë parasysh kufizimet e caktuara nga kërkesat e sekretit profesional dhe të biznesit.

Neni 25
Vështirësitë e bilancit të pagesave

1. Palët do të përpiqen kurdoherë që të jetë e mundur të mënjanojnë vendosjen e masave kufizuese, duke përfshirë masat në lidhje me importet, për qëllimet e bilancit të pagesave. Pala që merr masa të tilla i paraqet Palës tjetër, sa më shpejt që të jetë e mundur, një plan kohor për heqjen e tyre.

2. Nëse Shqipëria apo Turqia janë në vështirësi serioze për bilancin e pagesave, ose nën kërcënimin e afërt të tyre, Shqipëria ose Turqia, sipas rastit, në pajtim me kushtet e caktuara nën marrëveshjen e OBT-së, mund të marrin masa kufizuese, duke përfshirë masa në lidhje me importet, që do të jenë me kohëzgjatje të kufizuar dhe nuk mund të shkojnë tej asaj që është tepër e nevojshme për të korrigjuar situatën e bilancit të pagesave. Shqipëria ose Turqia, sipas rastit, do të informojnë menjëherë Palën tjetër.

3. Asnjë masë kufizuese nuk do të zbatohet për transfertat në lidhje me investimet dhe veçanërisht për riatdhesimin e shumave të investuara ose riinvestuara apo çdo lloj të ardhure që rrjedh prej tyre.

Neni 26
Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Palët në këtë Marrëveshje do të japin dhe do të garantojnë mbrojtje të përshtatshme, të

efektshme dhe jodiskriminuese të të drejtave të pronësisë intelektuale, duke përfshirë masat për realizimin e këtyre të drejtave kundrejt shkeljeve të tyre, falsifikimit dhe piratërisë, në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare.

2. Palët në këtë Marrëveshje do t'u japin shtetasve të njëra-tjetrës një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u japin shtetasve të tyre. Përjashtimi nga ky detyrim duhet të jetë në pajtim me dispozitat thelbësore të nenit 3 të Marrëveshjes TRIPS.

3. Palët në këtë Marrëveshje do t'u japin shtetasve të njëra-tjetrës trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jepet shtetasve të një vendi tjetër. Përjashtimet nga ky detyrim duhet të jenë në pajtim me dispozitat thelbësore të marrëveshjes TRIPS, veçanërisht neneve 4 dhe 5 të saj.

4. Zbatimi i këtij neni do të rishikohet rregullisht nga Palët. Nëse ndodhin probleme në sferën e pronësisë intelektuale, që cenojnë kushtet e tregtisë, do të fillohen konsultime urgjente, me kërkesë të njërës Palë, me qëllim arritjen e zgjidhjeve reciprokisht të kënaqshme.

Neni 27

Prokurimi publik

1. Palët e konsiderojnë liberalizimin e tregjeve të tyre përkatëse të prokurimit publik si një objektiv të kësaj Marrëveshjeje. Palët synojnë zgjerimin e dhënies së kontratave mbi bazën e mosdiskriminimit dhe reciprocitetit.

2. Palët do të zhvillojnë progresivisht rregullat, kushtet dhe praktikat e tyre përkatëse për prokurimin publik, me synim dhënien furnitorëve të Palës tjetër mundësinë për pjesëmarrjen në procedurat e dhënies së kontratës në tregjet e tyre përkatëse të prokurimit publik, jo më pak të favorshme se ai që u jepet shoqërive të çdo vendi apo territori.

3. Komiteti i Përbashkët do të shqyrtojë zhvillimet në lidhje me arritjen e objektivave të këtij neni dhe mund të rekomandojë modalitetet praktike të zbatimit të dispozitave të paragrafit 2 për të siguruar hyrje të lirë, transparencë dhe hapje reciproke të tregjeve të tyre përkatëse të prokurimit publik.

4. Gjatë shqyrtimit të përmendur në paragrafin 3, Komiteti i Përbashkët, veçanërisht nën dritën e zhvillimeve dhe rregullave ndërkombëtare në këtë fushë, mund të konsiderojë mundësinë e zgjerimit të mbulimit dhe/ose shkallën e hapjes së tregut të parashikuar në paragrafin 1.

5. Palët do të përpiqen të aderojnë në marrëveshjet përkatëse të negociuara nën kujdestarinë e GATT-it 1994 dhe të Marrëveshjes së Marrakeshit, që themeloi OBT-në.

Neni 28

Themelimi i Komitetit të Përbashkët

1. Themelohet një Komitet i Përbashkët në të cilin përfaqësohet secila Palë. Komiteti i Përbashkët është përgjegjës për administrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe siguron zbatimin e saj të përshtatshëm.

2. Për qëllimet e zbatimit të përshtatshëm të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të shkëmbejnë informacion dhe, me kërkesë të secilës Palë, do të mbajnë konsultime brenda Komitetit të Përbashkët. Komiteti i Përbashkët do të mbajë nën shqyrtim mundësinë e heqjes së mëtejshme të pengesave në tregtinë ndërmjet Palëve.

3. Komiteti i Përbashkët, në pajtim me dispozitat e paragrafit 3 të nenit 29, mund të marrë vendime në rastet e parashikuara në këtë Marrëveshje. Për çështjet e tjera Komiteti i Përbashkët mund të bëjë rekomandime.

Neni 29

Procedurat e Komitetit të Përbashkët

1. Për zbatimin e përshtatshëm të kësaj Marrëveshjeje, Komiteti i Përbashkët mblidhet në një nivel të përshtatshëm, kurdoherë që është e nevojshme, me kërkesë të njërës Palë, por të paktën një herë në vit. Secila Palë mund të kërkojë që të mbahet një mbledhje.

2. Komiteti i Përbashkët vendos me konsensus.

3. Nëse një përfaqësues i një Pale të kësaj Marrëveshjeje në Komitetin e Përbashkët ka pranuar një vendim, që i nënshtrohet rezervës për përmbushjen e kërkesave të brendshme ligjore,

vendimi hyn në fuqi, nëse atje nuk parashikohet një datë tjetër e mëvonshme, në datën e marrjes së njoftimit me shkrim, ku deklarohet se këto kërkesa janë përmbushur.

4. Komiteti i Përbashkët miraton rregullat e veta të procedurës që, ndërmjet të tjerash, përmbajnë dispozita të caktuara për thirrjen e mbledhjeve dhe caktimin e kryetarit dhe mandatin e tij.

5. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë për të krijuar nënkomitete dhe grupe pune që ai i konsideron të nevojshme për të asistuar në kryerjen e detyrave të tij.

Neni 30

Përjashtimet e sigurisë

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk i ndalon Palët të marrin çdo masë që ato e konsiderojnë të nevojshme për:

a) të parandaluar nxjerrjen e informacionit, në kundërshtim me interesat e saj thelbësore të sigurisë;

b) mbrojtjen e interesave të saj thelbësore të sigurisë ose për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare ose politikat kombëtare:

i) në lidhje me trafikimin e armëve, municioneve dhe instrumenteve të luftës dhe për atë trafik të mallrave, materialeve dhe shërbimeve të tjera që kryhet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt për qëllimet e furnizimit të një strukture ushtarake; ose

ii) në lidhje me mospërhapjen e armëve biologjike dhe kimike, armëve bërthamore dhe mjeteve të tjera eksplozive nukleare; ose

iii) në kohë lufte ose tensioni serioz ndërkombëtar që përbën kërcënim për luftë.

Neni 31

Përjashtime të përgjithshme

Kjo Marrëveshje nuk përjashton ndalimet ose kufizimet për importet, eksportet ose mallrat në transit, të justifikuar me arsyet e moralit publik, politikës publike ose sigurisë publike, mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve dhe ambientit, mbrojtjen e thesareve të brendshme që kanë vlera artistike, historike ose arkeologjike, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, ose rregullat në lidhje me arin ose argjendin, ose konservimin e burimeve natyrore në shterim, nëse këto masa janë bërë të efektshme në lidhje me kufizimet për prodhimin dhe konsumin vendas. Këto ndalime ose kufizime, megjithatë, nuk përbëjnë një mjet diskriminimi arbitrar apo kufizim të fshehur në tregtinë ndërmjet Palëve.

Neni 32

Përmbushja e detyrimeve

1. Palët marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse një Palë konsideron se Pala tjetër nuk ka përmbushur një detyrim në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Pala e interesuar mund të marrë masat e duhura brenda kushteve dhe në pajtim me procedurat e parashikuara në nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 33

Klauzolë zhvilluese

1. Nëse një Palë konsideron se do të jetë e dobishme dhe në interes të ekonomive të Palëve për të zhvilluar marrëdhëniet e vendosura nga kjo Marrëveshje duke i zgjeruar ato në fushat që nuk mbulohen prej saj, ajo i dërgon një kërkesë të arsyetuar Palës tjetër. Palët mund të udhëzojnë Komitetin e Përbashkët të shqyrtojë kërkesën dhe, sipas rastit, të bëjë rekomandime për to, veçanërisht me qëllim për hapjen e bisedimeve.

2. Marrëveshjet që rrjedhin nga procedurat e përmendura në paragrafin 1 i nënshtrohen ratifikimit ose aprovimit nga Palët në këtë Marrëveshje, në pajtim me legjislacionin e tyre vendas.

Neni 34
Amendimet

Amendimet në këtë Marrëveshje, si dhe në anekset dhe protokollet e saj, do të hyjnë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të kanaleve diplomatike, me anë të të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën se janë përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i tyre i brendshëm, për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 35
Protokollet dhe anekset

Protokollet dhe anekset e kësaj Marrëveshjeje përbëjnë një pjesë të pandarë të saj. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të ndryshojë protokollet dhe anekset në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palëve.

Neni 36
Vlefshmëria dhe tërheqja

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar.
2. Secila Palë e kësaj Marrëveshje mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër. Shfuqizimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të shtatë pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga Pala tjetër.
3. Palët bien dakord që, në rastin e aderimit të njërës prej Palëve të kësaj Marrëveshjeje në Bashkimin Europian, Marrëveshja shfuqizohet në datën para datës së aderimit në BE.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Palët do të ratifikojnë këtë Marrëveshje në pajtim me procedurat e tyre të brendshme.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë së cilës Palët informojnë njëra-tjetrën që janë përmbushur të gjitha kërkesat e nevojshme të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Si dëshmi të kësaj, të plotëfuqishmit e poshtëshënuar, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 22 dhjetor 2006, në tri origjinale, secila në gjuhët shqipe, turke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

SHTOJCA I E PROTOKOLLIT 3
SHËNIME PREZANTUESE TË LISTËS NË SHTOJCËN II

Shënim 1:

Lista vendos kushtet e kërkuara për të gjitha produktet për t'u konsideruar si të punuara ose përpunuara mjaftueshëm brenda kuptimit të nenit 6 të protokollit.

Shënim 2:

2.1 Dy kolonat e para në listë përshkruajnë produktin e përftuar. Kolona e parë jep numrin e kreut ose numrin e kapitullit, të përdorur në sistemin e harmonizuar dhe kolona e dytë jep përshkrimin e mallrave të përdorura në atë sistem për atë kre apo kapitull. Për secilën hyrje në dy kolonat e para specifikohet një rregull në kolonën 3 ose 4. Kur, në disa raste, hyrja në kolonën e parë parapritet nga një "ex", kjo nënkupton se rregullat në kolonën 3 ose 4 aplikohen vetëm për pjesën e atij kreu sikurse është përshkruar në kolonën 2.

2.2 Kur shumë numra krerësh grupohen së bashku në kolonën 1 ose jepet një numër kapitulli dhe kështu përshkrimi i produkteve në kolonën 2 jepet në terma të përgjithshëm, rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4 aplikohen për të gjitha produktet, të cilat, nën sistemin e harmonizuar, klasifikohen në

krerët e kapitullit ose në çdo kre të grupuar së bashku në kolonën 1.

2.3 Kur ka rregulla të ndryshme në listën që aplikohet për produkte të ndryshme brenda një kreu, secila pikë përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut të rregulluar nga rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4.

2.4 Kur, për një hyrje në dy kolonat e para, një rregull specifikohet në të dyja kolonat 3 dhe 4, eksportuesi mund të zgjedhë, si alternativë, që të aplikojë rregullin e vendosur në kolonën 3 ose atë të vendosur në kolonën 4. Në rast se nuk jepet ndonjë rregull origjine në kolonën 4, duhet të aplikohet rregulli i vendosur në kolonën 3.

Shënim 3:

3.1 Dispozitat e nenit 6 të protokollit, për sa u përket produkteve që kanë marrë statusin e origjinës, të cilat janë përdorur në prodhimin e produkteve të tjera, zbatohen, pavarësisht nëse ky status është marrë brenda fabrikës ku këto produkte po përdoren ose në një tjetër fabrikë në Shqipëri ose Turqi.

Shembull:

Një motor i kreut 8407, për të cilin rregulli thotë se vlera e materialeve pa origjinë të cilat mund të përfshihen në të nuk mund të kalojë 40% të çmimit ex-works është bërë nga "aliazh tjetër prej çeliku i formatuar për kudhër" të kreut ex 7224.

Në rast se ky çelik i temperuar është temperuar në Turqi nga një lëndë e parë pa origjinë, ky çelik ka marrë tashmë statusin me origjinë sipas rregullit për kreun ex 7224 në listë. Temperimi mund të llogaritet atëherë si me origjinë në vlerën e llogaritur për motorin, pavarësisht nëse çeliku u prodhua në të njëjtën fabrikë ose në një tjetër në Turqi. Vlera e lëndës së parë pa origjinë në këtë mënyrë nuk merret parasysh kur shtohet vlera e materialeve pa origjinë të përdorura.

3.2 Rregulli në listë përfaqëson sasinë minimale të kërkuar të punës ose të përpunimit, si dhe kryerja e më shumë pune apo përpunimi gjithashtu i jep statusin e origjinës; në të kundërt, kryerja e më pak pune apo përpunimi nuk mund t'i japë statusin e origjinës. Kështu, në rast se një rregull thotë se një material pa origjinë, në një nivel të dhënë të prodhimit mund të përdoret, atëherë përdorimi i këtij materiali në një stad të hershëm të prodhimit lejohet dhe përdorimi i tij në një stad të mëvonshëm nuk lejohet.

3.3 Pa cenuar shënimin 3.2, kur një rregull përdor shprehjen se: "Prodhimi nga materialet e çdo kreu" mund të përdoret, materialet e të njëjtit kre/krekë (edhe materialet e të njëjtit përshkrim dhe kre si produkti), megjithatë duke iu nënshtruar kufizimeve specifike që mund të parashikohen nga rregulli.

Sidoqoftë, shprehja "Prodhim nga materiale të çdo kreu, duke përfshire materiale të tjera të kreut …." ose "Prodhim nga materialet e çdo kreu duke përfshirë materiale të tjera të të njëjtit kre si produkti" do të thotë që mund të përdoren vetëm materiale të çdo kreu, përveç atyre të të njëjtit përshkrim si produkti i dhënë në kolonën 2 të listës.

3.4 Kur një rregull në listë specifikon se një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një material, kjo do të thotë që mund të përdoren një ose më shumë materiale. Ai nuk kërkon që të përdoren të gjitha materialet.

Shembull:

Rregulli për fabrikate të krerëve 5208 deri 5212 thotë se mund të përdoren fibrat natyrale dhe se materialet kimike, ndërmjet materialeve të tjera, mund të përdoren gjithashtu.

Kjo nuk do të thotë që të dyja duhet të përdoren; është e mundur të përdoret njëra ose tjetra, ose që të dyja.

3.5 Kur një rregull në listë specifikon se një produkt duhet të prodhohet nga një material i caktuar, ky kusht duket se nuk parandalon përdorimin e materialeve të tjera që, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të përmbushin rregullin (shiko gjithashtu shënimin 6.2 më poshtë në lidhje me tekstilet).

Shembull:

Rregulli për ushqimet e përgatitura në kreun 1904, i cili në mënyrë specifike përjashton përdorimin e drithërave dhe derivateve të tyre, nuk parandalon përdorimin e kripërave minerale, e kimikateve dhe shtesave të tjera, të cilat nuk janë prodhime nga drithërat.

Megjithatë, kjo nuk aplikohet te produktet, të cilat, edhe pse nuk mund të prodhohen nga materiale të veçanta të specifikuara në listë, mund të prodhohen nga një material i së njëjtës natyrë në një stad më të hershëm të prodhimit.

Shembull:

Në rastin e një artikulli veshjeje të ex kapitullit 62, i përbëre nga materiale jo të thurura, në rast se lejohet përdorimi i vetëm fillit pa origjinë për këtë lloj artikulli, nuk është e mundur të fillosh nga pëlhurë jo e thurur – edhe në se pëlhurat jo të thurura normalisht nuk mund të bëhen prej filli. Në raste të tilla, materiali fillestar duhet të jetë në një stad përpara të qenit fill, pra në gjendjen fibër.

3.6 Kur, në një rregull në listë, jepen dy përqindje për vlerën maksimale të materialeve pa origjinë që mund të përdoren, atëherë këto përqindje mund të mos shtohen së bashku. Me fjalë të tjera, vlera maksimale e të gjitha materialeve pa origjinë të përdorura nuk mund të kalojë asnjëherë përqindjen më të lartë të dhënë. Për më tepër, përqindjet individuale nuk duhet të tejkalohen, në lidhje me materialet e veçanta për të cilat ato aplikohen.

Shënim 4:

4.1 Termi "fibra natyralë" përdoret në listë për t'ju referuar fibrave të tjera nga ato artificialë ose sintetikë. Kufizohet për stadet përpara se të ndodhë tjerrja, duke përfshirë mbetjet dhe, nëse nuk specifikohet ndryshe, përfshin fibrat të cilat janë përdredhur, krehur ose përpunuar ndryshe, por që nuk janë kthyer në fill.

4.2 Termi "fibra natyralë" përfshin qimen e kalit të kreut nr.0503, mëndafshin e krerëve 5002 dhe 5003, po ashtu si dhe fibrat e leshit dhe qime të imët ose të ashpër kafshe të krerëve 5101 deri 5105, fibra pambuku të krerëve 5201 deri 5203, si dhe fibra të tjerë vegjetalë të krerëve 5301 deri 5305.

4.3. Termat "pulp tekstili", "materiale kimike" dhe "materiale për prodhim letre" përdoren në listë për të përshkruar materialet, e paklasifikuara në kapitujt 50 deri 63, të cilat mund të përdoren për të prodhuar fibra ose fije artificiale, sintetike ose letre.

4.4 Termi "fibra kryesorë të bëra nga njeriu" përdoret në listë për t'ju referuar filamenteve artificiale apo sintetike, fibrave zëvendësuese ose mbetjeve, të krerëve 5501 deri 5507.

Shënim 5:

5.1 Aty ku, për një produkt të dhënë në listë, bëhet referencë te ky shënim, kushtet e vendosura në kolonën 3 nuk zbatohen për ndonjë material bazë tekstili të përdorur në prodhimin e këtij produkti dhe të cilat, të marra së bashku, përfaqësojnë 10% ose më pak të peshës totale të materialeve bazë tekstile të përdorura (Shiko gjithashtu shënimet 5.3 dhe 5.4 me poshtë).

5.2 Sidoqoftë, toleranca e përmendur në shënimin 5.1 mund të aplikohet vetëm te produktet e përziera, të cilat janë bërë nga dy ose më shumë materiale tekstili bazë.

Materialet tekstile bazë, jepen si më poshtë :

- mëndafsh,
- lesh,
- qime kafshe e ashpër,
- qime kafshe e hollë,
- qime kali,
- pambuk,
- materiale për prodhim letre dhe letër,
- fije liri,
- fije kërpi,
- jute dhe fibra të tjera tekstili,
- sisal dhe fibra të tjera të gjinisë Agave,
- fibra nga arra kokosi, abaka, ramie dhe fibra të tjera vegjetale tekstile,
- filamente sintetike të bëra nga njeriu,
- filamente artificiale të bëra nga njeriu,
- filamente percjellëse rryme,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polipropileni,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliesteri,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliamidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliakrilonitrili,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliimidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej politetrafluoroetileni,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polifenileni sulfid,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polivinilkloridi,

- fibra të tjera sintetike të bëra nga njeriu,

- fibra artificiale të bëra nga njeriu prej viskoze,

- fibra të tjera artificiale të bëra nga njeriu,

- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibël prej polieteri, i përdredhur ose jo,

- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibël prej poliesteri, i përdredhur ose jo,

- produkte të kreut 5605 (fill i metalizuar), që përmban një rrip të përbërë prej shtrese alumini ose një mbulese prej filmi plastik, mbuluar ose jo prej pluhuri alumini, me një gjerësi që nuk kalon 5 mm, i palosur nëpërmjet një adezivi me ngjyra ose transparent ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik,

- produkte të tjera të kreut 5605.

Shembull:

Një fill, i kreut 5205, i bërë nga fibra pambuku të kreut 5203 dhe fibra sintetike të kreut 5506, është një fill i përzier. Për këtë arsye, fibrat sintetike pa origjinë, të cilat nuk plotësojnë rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materialet kimike ose pulp tekstili) mund të përdoren me kusht që pesha e tyre e plotë nuk i kalon 10% të peshës së fillit.

Shembull:

Një copë pëlhurë leshi e kreut 5112, e bërë prej filli leshi të kreut 5107 dhe filli sintetik prej fibrash të kreut 5509, është një pëlhurë e përzier. Për këtë arsye, filli sintetik i cili nuk plotëson rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materialet kimike pulp tekstili), ose filli i leshit, i cili nuk plotëson rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga fije natyrale, jo të përdredhura apo tjerra, ose të përgatitura ndryshe për fill), ose një kombinim i të dyjave, mund të përdoret, në rast se pesha e tyre totale nuk e kalon 10% të pëlhurës.

Shembull:

Pëlhurë tekstile, xhufke, e kreut 5802, e bërë prej filli pambuku të kreut 5205 dhe pëlhurë pambuku të kreut 5210, është vetëm një produkt i , në rast se pëlhura e pambukut është në vetvete një pëlhure e përzier, e prodhuar nga filli të klasifikuara në dy krerë të ndryshëm, ose në rast se filli i pambukut i përdorur është vetë një përzierje.

Shembull:

Nëse pëlhura tekstile, xhufkë në fjalë do të ishte e përbërë nga fill pambuku i kreut 5205 dhe pëlhurë sintetike e kreut 5407, atëherë, në mënyrë të dukshme, fijet e përdorura janë dy materiale bazë tekstili të veçanta dhe pëlhura tekstile xhufkë është, mbi këto baza, një produkt i përzier.

5.3 Në rastin e produkteve që përfshijnë "fill të bërë nga poliuretani i segmentuar me segmente fleksibël të polieterit, të përdredhur ose jo", kjo tolerancë është 20% në lidhje me këtë fill.

5.4 Në rastin e produkteve që përfshijnë "rrip i përbërë nga një shtresë alumini ose nga një shtresë prej filmi plastik, të mbuluar ose jo me pëlhurë alumini, me një gjerësi që nuk e kalon 5 mm, i palosur nëpërmjet një adezivi me ngjyra ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik, kjo tolerancë është 30% në lidhje me këtë rrip.

Shënim 6:

6.1 Kur në listë bëhet referencë në këtë shënim, materialet tekstile (me përjashtim të linjave dhe interlinjave), të cilat nuk plotësojnë rregullin e vendosur në listë në kolonën 3 për produktin në fjalë, mund të përdoren, me kusht që ato të jenë klasifikuar në një kre ndryshe nga ai i produktit dhe që vlera e tyre të mos kalojë 8% të çmimit ex-works të produktit.

6.2 Pa cenuar shënimin 6.3, materialet, të cilat nuk janë klasifikuar brenda kapitujve 50 deri 63, mund të përdoren lirshëm në prodhimin e produkteve tekstile, pavarësisht nëse përmbajnë apo jo tekstile.

Shembull:

Në rast së një rregull në listë thotë që, për një lloj të veçantë tekstili (të tilla si pantallonat) duhet përdorur fill, kjo nuk parandalon përdorimin e gjërave metalike, të tilla si kopsat, për arsye se kopsat nuk janë të klasifikuar në kapitujt 50 deri 63. Për të njëjtën arsye, nuk parandalohet përdorimi i zinxhirëve, edhe pse zinxhirët normalisht përmbajnë tekstil.

6.3 Kur një rregull përqindjeje aplikohet, vlera e materialeve të cilat nuk klasifikohen brenda kapitujve 50 deri 63, duhet të merren parasysh kur llogaritet vlera e materialeve pa origjinë të përfshira.

Shembull 7:

7.1 Për qëllimet e krerëve ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, “proceset specifike" janë si më poshtë:

a) distilim në vakum;

b) ridistilim nga një proces shumë i plotë fraksionimi;

c) ndarja;

d) riformimi;

e) përftimi me ndihmën e solventeve selektive;

f) procesi që përfshin të gjitha operacionet e mëposhtme: përpunimi me acid sulfurik të përqendruar, me anhidrit oleum ose sulfurik; neutralizimi me agjentë alkalinë; çngjyrimi dhe pasurimi me dhe aktiv natyral, me dhe aktiv, me qymyr ose boksid aktiv;

g) polimerizimi;

h) alkilizimi;

i) izomerizimi.

7.2 Për qëllimet e krerëve 2710, 2711 dhe 2712, “proceset specifike" janë si më poshtë:

a) distilim në vakum

b) ridistilim nga një proces shumë i plotë fraksionimi ([1]);

c) ndarja;

d) riformimi;

e) ekstraktimi me ndihmën e solventëve selektivë;

f) procesi që përfshin të gjitha veprimet e mëposhtme: përpunimi me acid sulfurik të përqendruar, me anhidrit oleum ose sulfurik; neutralizimi me agjentë alkalinë; çngjyrimi dhe pasurimi me dhe aktiv natyral, me dhe aktiv, me qymyr ose boksid aktiv;

g) polimerizimi;

h) alkilizimi;

ij) izomerizimi;

k) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të kreut ex 2710, desulfurizimi me hidrogjen, i cili rezulton nga një pakësim prej së paku 85 % të përmbajtjes së sulfurit të produkteve të përpunuara (Metoda ASTM D 1266-59 T);

l) në lidhje vetëm me produktet e kreut 2710, deparafinimi nga një proces tjetër nga filtrimi;

m) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të kreut ex 2710, trajtimi me hidrogjen, në një presion prej më shumë se 20 bar dhe një temperaturë prej më shumë se 250 °C, me përdorimin e një katalizatori, tjetër nga sjellja e desulfurizimit, kur hidrogjeni përbën një element aktiv në një reaksion kimik. Trajtimi i mëtejshëm me hidrogjen i vajrave lubrifikante të kreut ex 2710 (p.sh. hidrombarimi ose çngjyrimi), me qëllim që, në mënyrë më specifike, të përmirësohet ngjyra ose stabiliteti; ky trajtim nuk duhet sidoqoftë të konsiderohet një proces specifik;

n) në lidhje vetëm me vajrat për karburante të kreut ex 2710, distilim atmosferik, në kushte kur më pak se 30 %, sipas volumit, e këtyre produkteve distilohet, duke përfshirë humbjet, në 300 °C, me metodën ASTM D 86;

o) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të tjera nga vajrat e gazrave dhe vajrat për karburante të kreut ex 2710, trajtim me anë të shkarkesave fshirëse të tensionit të lartë;

p) në lidhje vetëm me produktet bruto për çvajosjen me kristalizim të pjesshëm (përveç xhelatinës së naftës, ozekerite, dyllë linjiti apo dyllë bitumi, dyllë parafine që përmban ndaj peshës më pak se 0.75% vaj) të kreut ex 2712.

7.3 Për qëllimet e krerëve ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, operacione të thjeshta, të tilla si pastrimi, dekantimi, çkripëzimi, ndarja e ujërave, filtrimi, ngjyrimi, vendosja e markës, përftimi i përmbajtjes sulfure si rezultat i përzierjes të produkteve me përmbajte të ndryshme sulfuri, ose çdo lloj kombinimi të këtyre operacioneve ose operacioneve të ngjashme, nuk japin origjinë.

SHTOJCA II

